



Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 9876/2018
Data: 03.12.2018

**PROCESVERBALI
I KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA**

Nga mbledhja e nëntë -IX- për vitin 2018 e Komitetit për Politik dhe Financa, mbajtur me datë 13.11.2018 me fillim pune në ora 11:00 në sallën e takimeve. Të pranishëm ishin: Mallzum Qajani (Nënkryetar i Komunës), Fari Kalisi (Drejtor për Administratë), Medina Imishti (Drejtoresh për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale), Zaim Bela (Drejtor për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural), Shabi Rexhallari (Drejtor për Buxhet dhe Financa), Nexhmedin Daci (Drejtor për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit), Bashkim Sopa (Zyrtar për transparencë), Irfan Suma (Asistent i Kryesuesit të Kuvendit të Komunës), Përfaqësuesi i OSB-së. Kryesuesi pasi konstatoi prezencën e anëtarëve të KPF-së, konstatoi se nuk mungon asnjë anëtarë i Komitetit për Politik dhe Financa.

RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Informatë mbi ndarjen e subvencioneve në bujqësi.
3. Informatë mbi gjendjen në shëndetësi.

Kryesuesi thekson:- për pikat e rendit të punës hapi diskutimin.

Mehmet Ballazhi thekson:- edhe në KPF dhe në Kuvend do të ishte mirë që me figuruar si pikë e rendit punës të ndryshme.

Akif Shkreta thekson:- unë mendoj se në bazë të rregullave duhet të jetë në kuvend pikë e rendit të punës pyetje dhe përgjigje por edhe pikë e veçantë të ndryshme.

Kryesuesi thekson:-a ka edhe ndonjë diskutim, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri. (prezent ishin të gjithë anëtarët e komitetit për politik dhe financa).

MIRATOHET RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutim, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri (prezent ishin të gjithë anëtarët e komitetit për politik dhe financa).

MIRATOHET PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

2. Informatë mbi ndarjen e subvencioneve në bujqësi.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Zaim Bela thekson:- subvencionet janë ndarë për tri kategori, për mbjellje të grurit, për serra dhe për pula vajëse. Në tabelën më poshtë janë edhe shënimet për fermerët të cilët kanë përfituar nga pagesat direkte nga Ministria e Bujqësisë. Organizata joqeveritare “Lab” ka dhënë donacione dhe përfitues ishin të gjithë ata që kanë aplikuar, mirëpo fermeri është dashur me participuar 30 % të vlerës së projektit sepse deri vitin e kaluar ishte 10 %. Ka mbetur pa u shpërndarë një serrë dhe dy fermerë kanë mundur me përfituar pula vajëse por nuk kanë aplikuar. Labi ka ndarë për një fermerë mjetet për përpunimin e jogurtit nga qumështi i deleve që është veprimtari e veçantë që deri më tani askund në Kosovë nuk është aplikuar. Materialin e keni pranuar me kohë dhe nëse keni ndonjë vërejtje mund të parashtroni.

Akif Shkreta thekson:- për dallim nga viti i kaluar që ka qenë pjesëmarrja e fermerit 10 % të vlerës së projektit, në këtë vit participimi i fermerëve ka qenë me një shumë 30 % të vlerës së projektit që ka ndikuar të humbin katër projekte në vlerë prej 30 000 €. Është mirë me ndërhyjë komuna dhe drejtoria për bujqësi me gjet mënyrë që mos me humbur projektet për shkak të participimit dhe të stimulohen fermerët. Po që se bëhet një krahasimi në nivel komunal me mbjellje të grurit nuk jemi mirë. Për vitet e ardhshme nëse është pengesë pagesa në vlerë të projektit në shumë prej 30 % është mirë që të intervenon komuna apo të hiqet në mënyrë që mos të humbin projektet ashtu siç ka ndodhë .

Nora Xhoni thekson:- humbja e projekteve për të cilën vlera është 30 000 € më doket pak e çuditshme por me siguri ka ndikuar participimi në projekt prej 30 %. Herëve të tjera 30 % është mirë me u heqë krejt dhe me bërë njoftime sa më shumë që me qenë më të njoftuar qytetarët.

Kryesuesi thekson:- shumën prej 30 % kush e ka përcaktuar.

Samire Curri thekson:- sa përfituese prej këtyre subvencioneve janë femra.

Mehmet Ballazhi thekson:- çështja e 30 % është përcaktuar prej LAB-it dhe nuk di sa mundemi me ndërhyjë por është mirë që me bërë ndonjë momerandum të bashkëpunimit. Mendimi imë është që 30 % me zhvendosë në komunë duke shikuar bazë ligjore dhe procedurat që janë në komunë. Participimin e fermerit me kryer komuna duke i shikuar mundësitë buxhetore sepse përcaktimi i kriterëve për ndarjen e projekteve është çështje e Labit. Në informatë lexova që janë 1335 koshere të bletëve, mirëpo e di që ka pas një problem që nuk janë subvencionuar apo ku qëndron problemi. Përveç LAB-it dhe Ministrisë së Bujqësisë, sa ka subvencionuar vetëm komuna. Për mbjellje të grurit është mirë që me i gjet mënyrat se si me i nxitur që fermerët me mbjell grurë.

Zaim Bela thekson:- mjetet financiare për LAB-in i ndanë kompania “Sharrcem” i bënë planifikimet. Selia kryesore e kompanisë “Sharrcem” në bazë të informatave të LAB-it që kemi ka kërkuar që 50 % me qenë participimi nga fermeri sepse mendimi i tyre ka qenë se disa fermerë nuk ishin të përgjegjshëm. Bordi i kompanisë “Shaarrcem” ka vendosë që participimi i fermerit me qenë 30 %. Ne kemi diskutuar që kjo shumë është e madhe dhe mbetet në të ardhmen se si të vendosin sepse jemi në bisedime për këtë çështje. Femrat nuk po aplikojnë por projekti për pulat vajëse ka qenë më shumë për femrat dhe ka pas prej tyre që kanë aplikuar dhe janë përfituese. Sa i përket mbjelljes së grurit komuna mund t’i subvencionojë me farë të grurit dhe plehrat që nevojiten. Vetëm komuna ka subvencionuar 4058.80 € në sektorë të ndryshëm .

Mallzum Qajani thekson:- është sektorë i rëndësishëm për Hanin e Elezit dhe është e vërtetë se 30 % është pakë problem për fermerët, mirëpo i ka dy qëllimi. Qëllimi i parë është me dhënë projekte pakë më shumë dhe qëllimi i dytë është që projektet me qenë më të qëndrueshme për shkak se në territorin tonë disa projekte që i ka dhënë LAB-i personat të cilët ishin përfitues nuk ishin me intensitet të plotë që ai projekt të ketë sukses. Sa i përket propozimit që komuna të participon për pjesën e fermerëve, komuna për vitin 2019 e ka miratuar buxhetin dhe në atë buxhet nuk kemi planifikuar. Për vitin 2020 komuna duhet t’i shikon mundësitë buxhetore për këtë çështje.

Mehmet Ballazhi thekson:- nuk besojë që është strikt kjo çështje sepse brenda vitit 2019 mund të ketë rishikim të buxhetit dhe bartje të mjeteve financiare sepse nuk do të thotë që subvencionet të epen në muajin janar apo qershor por brenda vitit mund të lëvizet. Më së miri do të ishte që me i destinuar drejtë sepse po të marrim shembull mjedrat nuk ka dal i efektshëm tregu dhe duhet që komuna me pas parasysh këtë por me subvencionuar aty ku ka leverdi dhe efekt.

Mallzum Qajani thekson:- buxheti është i planifikuar dhe nuk lejon niveli qendrorë me krijuar projekt të ri dhe me i bartë mjetet por për vitin 2019 është i planifikuar dhe i miratuar e nuk mund të lëvizim prej kësaj. Varte prej Qeverisë se a ka rishikim të buxhetit dhe rishikimi varet në modalitetet që bëhen.

Shabi Rexhallari thekson:- Ministria i cakton tavanet për çdo komunë dhe për vitin 2019 janë 61000 € dhe kur është miratuar buxheti 15 000 € ja për bursa të studentëve , pastaj dedikohet për financimin e klubeve sportive, pastaj për pagesën e lehonave dhe ndihma të tjera.

Zaim Bela thekson:- bletarët kanë përfituar prej pagesave direkte nga Ministria e Bujqësisë për çdo koshere bletë janë ndarë nga 15 €. Në bazë të informacioneve që kam bletarët në këtë vit kanë qenë më mirë se para pesë apo gjashtë viteve sepse me mjaltë ka qenë më i mirë ky vit. Si shoqatë e bletarisë ka kërkuar që tu epet edhe një ndihmë por nuk kemi mundësi buxhetore por edhe sikur të kishim pas mundësi buxhetore do të ju ndihmoja fermerëve të mjedrave sepse kanë pësuar shumë keq në këtë vit.

Kryesuesi thekson:- sa është kostoja e përgjithshme për funksionimin e LAB-it për një vit. Kompania “Sharrcem” sa e deklaroi shumën për funksionimin e komplet LAB-it për një vit. Sa është kostoja e mjeteve financiar e katër përfituesve për këtë vit. Më shumë po kemi mos sukses të politikave të LAB-it se sa të defektet e tjera sepse participimi me 30 % është dështim i LAB-it e jo i fermerëve por duhet të analizohet edhe të fermerët për shkak se shumatat të cilat parashihen në projekte mos janë shuma të fryra. Shumat e LAB-it për funksionim janë tepër të larta kurse pjesa më e madhe shpenzohet në administratë sepse ndoshta 200 000 € ndahen për LAB-in kurse 100 000 € shpenzohen për mirëmbajtje dhe kur të kthehen në projekte vlera është shumë e ulët. Komuna duhet të kërkon që ata me i ndryshuar politikave ndaj komunitetit.

Zaim Bela thekson:- në bazë të informatave që i kam politikave i ndryshon “Sharrcemi” sepse ai është donatorë dhe asnjë herë nuk ka qenë e njëjta shumë. Ata kanë politikave të tjera sepse e llogarisin fitimin dhe i ndajnë mjetet financiare dhe rruga që është shtruar të përroi i lagjes re mjetet financiare janë marr nga LABI. Të gjitha donacionet që epen në nga LAB-i procedurat zhvillohen përmes tenderimit dhe asnjë herë nuk kam dëgjuar që i është dhënë tenderi dikujt që ka qenë me çmim më të shtrenjtë por tenderi ju është dhënë atyre që i kanë plotësuar kushtet. Po të merren shënimet afër 700 000 € apo 800 000 € janë investuar prej LAB-it në komunën tonë.

Kryesuesi thekson:- në takim që kemi pas me “Sharrcemin” nuk i përmendim shumatat të cilat investohen në projekte por e përmendim shumën e përgjithshme të LAB-it. Në takimet që i kemi pas në mandatin e kaluar me përfaqësuesit e kompanisë “Sharrcem” kanë deklaruar se 290 000 € i ndajnë për LAB-in. Në bord për komunitete janë deklarua se do t’i japin 60 000 € por gjithmonë vetëm 15 000 € i kanë dhënë dhe rregullisht kur kemi kërkuar ndihma prej kompanisë “Sharrcem” ata kanë potencuar se në LAB i japim 290 000 €. Në atë buxhet që e përmend “Sharrcemi” për LAB-in nuk e llogarisin që një pjesë e mjeteve financiare shpenzohen për punëtorë e qira të objektit dhe për ekspertë të ndryshëm.

Mehmet Ballazhi thekson:- shihet qartë se nuk ka asnjë lloj të bashkëpunimit në mes komunës dhe kompanisë “Sharrcem”. Me sa jam i njoftuar është një memorandum i bashkëpunimit me LAB-in sepse investitorë është “Sharrcemi” që e menaxhon LAB-in. Komuna mund të sugjerojë që mos me investuar në këto sektorë por jo me detyrim por shihet që komuna nuk ka bashkëpunim me “Sharrcemin” që me i orientuar investimet më drejtë. Nëse ka pas një rregull që me ndarë 60 000 € dhe nuk i ka ndarë do të thotë që është pa aftësi dhe mos aftësi e juaja. Shihet që po mungon një bashkëpunim se edhe në kuvend e keni potencuar që nuk ka një bashkëpunim por ju gjeni mundësitë dhe bashkëpunoni për çështje të ndryshme sepse nuk është vetëm LAB-i por duhet të ketë edhe qasje të tjera me komunitetin jo vetëm për LAB-in. Është diskutuar për me formuar një grup në kuadër të kuvendit por jeni vonuar dhe kjo është vonesë e pozitës.

Akif Shkreta thekson:- nuk është e vërtetë që ka munguar bashkëpunimi sepse ka qenë, por herë prishet herë rregullohet. Unë mendoj që duhet të ketë marrëveshje me “Sharrcemin” e jo me të joshë “Sharrcemi” e jo me formuar një bord të qytetarëve siç ka qenë më herët dhe me zhvendosë problemin në komunë dhe komuna me formuar një bord dhe ai bord me ju ndarë ndihma qytetarëve në mjete financiare që është shumë e keqe. Me “Sharrcemin” duhet të bëhet marrëveshje me shkrimë qoftë ekzekutivi qoftë legjislativi dhe të precizohen gjitha çështjet. Duhet ta ketë parasysht “Sharrcemi” që na nuk jemi sy mshel por jemi duke e parë që Hani i Elezit është një ndër komunat që e potencojë vetë zëvendësministri z.Morina që është një ndër komunat me ndotje ekstreme.

Mallzum Qajani thekson:- kompania “Sharrcem” krijon vetë politikat e veta dhe nuk e pyet komunën se çfarë politika të bëjë unë dhe komuna nuk ka kurrë farë mos marrëveshje. “Sharrcemi” ka premtuar që do të kontribuonë te LAB-i, ka premtuar që do të ndihmon edhe një këshill për ndihmë komunitetit. Kompania “Sharrcem” ka prezantuar se ka një gjendje jo të mirë financiare për vitin 2018 dhe ka potencuar që unë nuk mund të ndihmojë në shkallën e premtimeve dhe komuna nuk ka asnjë mos marrëveshje me “Sharrcemin” dhe ajo që u potencua që komuna duhet të bënë marrëveshje, unë mendojë që marrëveshje mund të bësh kur dy palët janë të interesuara për marrëveshje. “Sharrcemi” e financon LAB-in dhe komunitetit varësisht nga forma e gjendjes financiare brenda institucionit.

Nora Xhoni thekson:- unë mendoj që participimi në shumë prej 30 % është që fermeri me pas kujdes më shumë për projektin sa ka raste që fermeri e ka lënë projektin në gjysmë.

Mehmet Ballazhi thekson:- është e qartë që marrëveshjet bëhen kur janë dy palët e interesuara por nuk është mirë me mbuluar mos bashkëpunimin sepse mungesa e bashkëpunimit në sektorë të ndryshëm në mes komunës dhe “Sharrcemit” është zero përveç se mund të jetë e një interesi të grupit të vogël ndoshta. Si mundet kryetari i komunës me dal e mi ndalë punimet kompanisë “Bektelenka” pa e ndal hiq se pe dimë që është mediale e nuk po paska mundësi me hap një farë rruge të bashkëpunimit me “Sharrcemin”. Merren iniciativa individuale për interesa politike me bërë projekte të ndryshme me përfitime të grupeve të vogla të interesit e nuk po mundet për një interes shumë madhorë qytetarë me bashkëpunuar me LAB-in dhe “Sharrcemin” që është donatorë i LAB-it. Ne nuk pe themi as për inati as për politik por gjeni mundësin dhe modulën për me bashkëpunuar sepse mungon bashkëpunimi.

Kryesuesi thekson:- si anëtarë të kuvendit kemi marr votat e qytetarëve dhe duhet ta japim kontributin tonë. Si kuvend e formojmë një grup punues dhe këto probleme i diskutojmë. Duhet t’i shikojmë interesat tona të qytetarëve të jemi unik sepse interesi është i përgjithshëm. A ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri (prezent ishin të gjithë anëtarët e komitetit për politik dhe financa).

U VOTUA INFORMATA MBI NDARJEN E SUBVENCIONEVE QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

3. Informatë mbi gjendjen në shëndetësi.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Medina Imishti thekson:- jemi munduar me i paraqitur në detale informacionet në shëndetësi . Te stafi kemi pas dymbëdhjetë punëtorë me shërbime të veçanta. Vaksinimi ka qenë prej muajit qershor sepse ka qenë projekti vizitë nënave dhe fëmijëve deri në moshën tri vjeçare. Në muajin tetor te laboratorit nuk ka pas shërbime për shkak se punëtori ka marrë pushim gjashtë muaj pa pagesë dhe tash është funksional edhe laboratorit. Kemi shënuar numrin e pacientëve që janë shërbe prej barnatores dhe llojin e barnave që e kanë marrë. Participimi është shumë i vogël për shkak se në rregulloren për taksa dhe tarifa janë shumë kategori që lirohen nga participimi dhe më shumë kanë marrë shërbime pacientët të cilët kanë qenë mbi moshën 65 vjeçare. Janë mbajtur trajnime në kuadër të punëtorëve shëndetësorë. Ligjërata janë mbajtur nëpër shkollat. Kemi pas edhe disa donacione të ndryshme. Materialin e kemi para vetës dhe nëse kemi ndonjë vërejtje mund të parashtroni.

Mehmet Ballazhi thekson:- a kemi mungesë të barnave esenciale nga listat që i kemi ju dhe nëse ka cilat janë ato barna të cilat mungojnë me na i përcjellë për kuvend. A i kemi identifikuar shkaqet e sëmundjes me kancer që po ndodhin në komunën tonë. Sa është numri i rasteve me kancer se besoj që i kemi si QKMF.

Medina Imishti thekson:- po ka barna që janë në listë esenciale dhe nuk i binë. Rastet me kancer nuk i kam përfshirë në këtë informatë për shkak se kam menduar që në raport në fund vit me i përfshirë në përgjithësi.

Mallzum Qajani thekson:- për personat të cilët janë me kancer në ambulantë e kanë vetëm diagnozën kancer dhe nuk kanë se cilat janë shkaqet që e kanë sjellë.

Samire Curri thekson:- kërkoj sqarim për çështjen e mjekëve të cilët punojnë vetëm nga gjashtë muaj dhe pastaj e ndërpresin kontratën. Pse nuk kemi shërbime dentare në QKMF

Medina Imishti thekson:- kemi problem me çështje të mjekëve sepse nuk ka.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri, (prezent ishin të gjithë anëtarët e komitetit për politik dhe financa).

U VOTUA INFORMATA MBI GJENDJEN NË SHËNDETËSI QË TË PËRCILLET PËR KUVEND.

Mbledhja përfundoi në ora 12:10 ju faleminderit për pjesëmarrje.

Procesmbajtësi
Avni Bushi

